



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.05.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

1. Konstituimi i Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të Nënkomisionit për periudhën 10 maj – 30 korrik 2018.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Xhemal Qefalia, Jurgis Çyrbja.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi,, Edmond Panariti.

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Përsëritje! Kjo është mbledhja e parë e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut. Në rendin e ditës ka vetëm dy çështje: konstituimi i Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut dhe miratimi i kalendarit të punimeve të Nënkomisionit për periudhën 10 maj - 30 korrik 2018.

Në fakt, të nderuar kolegë, përpara keni një draftkalendar. Nëse keni mendime dhe sugjerime për të shtuar aktivitete, jeni të mirëpritur. Është bërë edhe një ndarje me ditë dhe orë të caktuara për muajin maj. Ndërkohë, për muajt qershor dhe korrik është një program, i cili do të detajohet në vijim. Disa aktivitete mund të jenë të përbashkëta me nënkomisionet e tjera. Në fund të kalendarit kam vënë shënimin, që mund të bashkëpunojmë me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe për Parandalimin e Dhunës ndaj Grave për çështje që lidhen me organe të qeverisjes vendore, me të drejtat e njeriut, të cilat janë në kompetencë të Komisionit të Ligjeve, dhe me nënkomisionin që drejton Eglantina. Unë sugjeroj të kemi bashkëpunime dhe veprimtari të përbashkëta edhe me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve”, kur bëhet fjalë për të drejtat e fëmijëve në vendet e paraburgimit, në komisarate, në burgje, ose për trajtimin e të miturve në sistemin e drejtësisë penale apo edhe për aspekte të tjera. Në fakt, ishte përgatitur një kalendar më i gjerë. Një pjesë e veprimtarive, edhe më kërkesë të kryetarit të Komisionit të Ligjeve, u vendos të bëhen nga Komisioni i Ligjeve, janë disa seanca dëgjimore, sidomos ato që kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit të ligjit “Për ndihmën juridike”, për zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ose për çështjet që lidhen me pakicat kombëtare.

Nuk e di se çfarë mendimesh keni për kalendarin. Unë do të doja mirëkuptimin tuaj që ta miratonin këtë kalendar dhe të fillonim me një aktivitet shumë të rëndësishëm për Shqipërinë, i cili është javën tjetër në datën 16. Qeveria shqiptare raporton në Gjenevë për zbatimin e konventës “Për mbrojtjen e personave nga zhdukja me forcë”. Është një raportim ku do të përfshihen shumë institucione, ndër të cilat do të jenë Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informimin e Dokumenteve të Ish-Sigurimit të Shtetit dhe Ministria e Punëve të Jashtme. Delegacioni duhet të jetë i nivelit të lartë, me një përfaqësim të mirë dhe me përgatitje. Unë do të doja, edhe në bazë të kërkesës që na është bërë herë pas here nga institucionet ndërkombëtare, por edhe nga detyrimet që kemi për nxitjen e parlamentarëve për rritjen e cilësisë së raportimeve dhe ndjekjen e zbatimit të raporteve për konventa, që seancën e parë dëgjimore dhe aktivitetin e parë të nënkomisionit ta

fillonim pikërisht me këtë seancë dëgjimore me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e personave nga zhdukja me forcë të dimë se çfarë ka bërë qeveria shqiptare, çfarë masash ka marrë lidhur me raportimin, përgatitjen, delegacionin që do të shkojë dhe rolin që luan Kuvendi i Shqipërisë.

Ne kemi pasur një takim me komisionerin e Kombeve të Bashkuara në Kuvendin e Shqipërisë, kemi bërë një raport në vitin 2016 dhe kemi disa detyrime dhe detyra të lëna në kuadër të vizitës që bëri komisioneri i Kombeve të Bashkuara. Kjo ishte për informacion.

Eglantina Gjermeni – Jemi parimisht dakord për seancat dëgjimore, por a do të jenë të gjitha institucionet përgjegjëse, Ministria e Jashtme dhe e Brendshme, a ftohen të gjithë?

Vasilika Hysi –Po, sepse janë të gjitha përgjegjëse.

Eglantina Gjermeni – Kur është afati i raportimit?

Vasilika Hysi – Intervistat do të zhvillohen në datat 14-18 maj dhe raportimi është javën e tretë të majit, më 24 maj 2018. Pra, i bie më pak se dy javë, do të jetë në Gjenevë, do të shqyrtohet nga komiteti i ekspertëve të konventës dhe...

Eglantina Gjermeni – Më fal, por duhet të na dërgojnë një informacion paraprak.

Vasilika Hysi – Unë i kam kërkuar Ministrisë së Punëve të Jashtme raportin e qeverisë shqiptare dhe, sapo ta marrim raportin, do t'ju ndajmë për të parë problematikat dhe rekomandimet. Ndërkohë, unë do t'ju vë në dispozicion edhe rekomandimet e komisionit të Kombeve të Bashkuar kur kanë vizituar Shqipërinë në vitin 2016, çfarë shqetësimesh kanë ngritur dhe çfarë kanë kërkuar nga qeveria shqiptare.

Edlira, mund t'ua nisim me email edhe kolegëve të opozitës.

Ndërkohë, unë sugjeroj që, përveç komisionit tonë, mund të ftojme edhe deputetë të tjerë të interesuar, qoftë nga Komisioni i Ligjeve, ose nga ata që kanë interes për çështjet që lidhen me mbrojtjen e personave nga zhdukja me forcë. Nuk është vetëm rasti i Remzi Hoxhës, por ka edhe raste të tjera, që janë zhdukur, nuk janë gjetur dhe që ne kemi përgjegjësinë për t'i adresuar shqetësimet.

Xhemal Qefalia - Patjetër që programi dhe kalendari janë orientues, por mendoj se nënkomisioni, që të jetë më efikas, për ngjarjet që bëhen publike, për shembull, në qoftë se diçka bëhet mediatike, një rast dhune në komisariat e të tjerë, duhet të reagojë menjëherë, në mënyrë që t'i japim vlerë dhe rëndësi këtij nënkomisioni.

Vasilika Hysi – Jam dakord.

E kemi bërë në përgjithësi, por do ta bëjmë edhe më shumë.

A ka ndonjë mendim tjetër?

Meqenëse këtu kemi edhe Eglantinën, anëtare të komisionit, e cila drejton Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, që ka hartuar një kalendar veprimtarish shumë të mira, do të ishte e domosdoshme që disa aktivitete t'i bëjmë bashkë. Njëkohësisht, zoti Fino, i cili drejton Nënkomisionin për Organet e Vetëqeverisjes Vendore, ka hartuar një kalendar për disa çështje, për të cilat kemi menduar të bëjmë edhe aktivitete të përbashkëta që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut në nivel vendor, por disa prej tyre lidhen edhe me nënkomisione të tjera. Ne mund të kemi veprimtari të përbashkëta që lidhen me Nënkomisionin për Administratën Publike. Për shembull, unë do të sugjeroj një vizitë në Shkollën e Administratës Publike, për të diskutuar kurrikulën e shkollës lidhur me parandalimin e diskriminimit dhe trajtimin e minoriteteve. Mund të ishte shumë i mirë bashkëpunimi edhe me Nënkomisionin e Barazisë Gjinore për të parë se si adresohen në kurrikulat e ASPA-s problemet për trajnimin dhe formimin e nëpunësve civilë. A jeni dakord që ta miratojmë si draft? Parimisht, jemi të gjithë dakord, nuk ka asnjë votë kundër nga të pranishmit.

Ndërkohë, Xhemal, ju lutem shumë, sa herë që të mësoni raste, jo vetëm nga media, por sidomos nga komisariatet e policisë dhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë Tiranës, na njoftoni, sepse ne si komision mund të marrim një mision monitorimi.

Shumë faleminderit!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA